



Kjo faqe interneti është pronë e Credins bank Sh.a. Përmbajtjet e të gjitha informacioneve, dok umentave që ndodhen në web mund të jenë pjesë dhe e palëve të treta partnere të Bankës.

Nëse hyn në rrjet, përdoruesi pranon ti nënshtrohet kushteve dhe afateve të mëposhtme. E gjithë përmbajtja e kësaj faqeje interneti është subjekt i të drejtës së autorit me të gjitha të drejtat e rezervuara. Ndalohet çdo kopjim, ruajtje, shkarkim, riprodhim, shpërndarje, modifikim, apo veprim tjetër në përmbajtjen e kësaj faqeje interneti, si edhe në aplikimet e ofruara aty, pa aprovimin paraprak të Credins bank Sh.a, duke përjashtuar këtu çfarë lejohet nga Ligji i të Drejtës së autorit.

## Shënim i rëndësishëm ligjor

Duke hapur dhe/ose përdorur informacionin, shërbimet, lidhjet, funksionet, aplikimet ose programet (këtej e tutje: “përmbajtjet”) e ofruara në këtë faqe interneti, përdoruesi me anë të këtij dokumenti pranon ti nënshtrohet kushteve dhe afateve të paraqitura më poshtë:

## Të drejtat e autorit dhe të drejtat e pronësisë industriale

Përmbajtjet e ofruara (foto, video, audio, logot, dizenjot, tekstet, grafika etj.) të cilat do të konsiderohen si pjesë e përmbajtjes në këtë faqe interneti (këtej e tutje: “Faqe interneti”) dhe nën-faqet e saj mbrohen nga ligji për të drejtën e autorit dhe ligji për pronësinë industriale. Shkarkimi ose ruajtja e aplikimeve ose programeve që përmban kjo Faqe interneti dhe riprodhimi (i plotë ose i pjesshëm), transmetimi, modifikimi ose lidhja e përmbajtjeve të kësaj faqeje interneti do të lejohet vetëm me miratimin me shkrim të Credins bank Sh.a. Megjithatë, përdoruesit kanë të drejtë të printojnë, shkarkojnë, ose të ruajnë faqe të veçuara ose pjesë të kësaj faqeje sipas dispozitave të ligjit të drejtës së autorit dhe vetëm nëse shënimet e të drejtës së autorit ose shënime të tjera të mbrojtura me ligj as nuk fshihen as nuk ndryshohen.

## Investimi ose kërkimi nuk realizohet nëpërmjet faqes së internetit:

Përmbajtjet e Faqes së internetit do të shërbejnë vetëm për informacion dhe nuk do të konsiderohen si kërkim apo ofertë për të blerë ose për të shitur ndonjë lloj instrumenti investimi sipas ligjeve që aplikohen të tregut të kapitaleve. Çdo vendim investimi konkret duhet të paraprihet nga një takim me këshilluesin financiar dhe ne do të ishim të kënaqur t’ju ofronim shërbimet tona në lidhje me këtë pikë.

## Përmbajtja e Informacionit

Credins bank Sh.a. ka bërë të gjitha përpjekjet për të krijuar siguri në kërkimin e informacionit të publikuar në Faqen e tij të internetit sikurse edhe në selektimin e burimit të informacionit të përdorur. Megjithatë, Credins bank Sh.a. nuk merr përsipër përgjegjësi mbi saktësinë dhe disponueshmërinë pa ndërprerje të informacionit të mundësuar në Faqen e tij të internetit ose në lidhje me burimet e informacionit të përdorur. Çdo analizë tregu, çmim apo analizë kompanie sikurse edhe parashikimet e publikuara në Faqen e internetit bazohen në informacionin e mundësuar dhe në vlerësimin e tregut në kohën kur është shënuar në publikimin përkatës. Analizat e kompanisë mund të mbështeten pjesërisht në informacionin e marrë drejtëpërdrejtë nga burimet e kompanive përkatëse.

## Mbrojtja e të dhënave personale :

Credins Bank Sh.a. garanton që të dhënat personale të përdoruesve të mbledhura duke naviguar apo duke përdorur shërbimet do të përpunohen në përputhje të plotë me parashikimet e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, (shiko politikat e privatësisë).

## Përjashtim nga përgjegjësia:

Credins bank Sh.a. nuk jep garanci dhe nuk do të pranojë përgjegjësi për ndonjë dëm në lidhje me hyrjen në Faqen e internetit, hapjen, përdorimin ose pyetjet mbi përmbajtjet e Faqes së internetit. Kjo është e vlefshme edhe në rastet kur Credins bank Sh.a. vë në dukje mundësinë e ndodhjes së këtyre dëmeve. Për më tepër, Credins bank Sh.a. nuk do të jetë i përgjegjshëm për ndërprerjet teknike si p.sh. probleme në server, ndërprerje ose dështim në lidhjet e telekomunikacioneve si edhe për ngjarje të ngjashme, të cilët mund të çojnë në padisponueshmërinë (e përkohshme) të gjithë Faqes së internetit.

## Nryshimet ne Faqen e internetit:

Credins bank Sh.a. ka të drejtën të ndryshojë dhe të fshijë Faqen e internetit në çdo kohë (nëse është e nevojshme edhe pa lajmërim paraprak), veçanërisht në lidhje me ndryshimin e përmbajtjes ekzistuese dhe duke shtuar përmbajtje të reja.